

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Ujësjellësi dhe Policia kanë hyrë në pronën time pa leje apo urdhër, faturat i paguaj rregullisht"
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1392054.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 12:47:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	16 shtator 2026, 12:33:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 16 shtator 2026, 12:32:00 UTC → 16 shtator 2026, 12:34:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	73d3a973063df2042b7f6b42525d5e09a81492da868f04f19f1f081955130062
TEKSTI	3c06c4d76b97e675c3907d30445aa0a0b3802eb69dfd2a3c861d43893188d0ca
PAMJA	2a35fc2f5bb21493d0092a2ff80dada6061967028a99e1c91bfc48a1439e640f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ce45db56037bc36de77417f996e866ee4ffb0436d1cd391d45cafc5b83877401
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9235283646fceb4f2e036f737b53ac1b0d6441cb2e31166fde86e3118480b863
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ce45db56037bc36de77417f996e866ee4ffb0436d1cd391d45cafc5b83877401>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

“Ujësjiellësi dhe Policia kanë hyrë në pronën time pa leje apo urdhër, faturat i paguaj rregullisht”

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 16.09.2026, 14:33



Share



Share



Një qytetar, banor i Linzës, në Dajt, ka kontaktuar redaksinë për të denoncuar një kontroll të kryer nga punonjësit e ujësjiellësit Tiranë në bashkëpunim me Policinë e Shtetit.

Qytetari tregon se familja e tij ndodhej në spital dhe se në momentin kur punonjësit e ujësjiellësit dhe policia kanë mbërritur në banesë, nuk ndodhej askush në shtëpi.

Sipas tij, personat kanë hyrë në oborr dhe në ambientet e pronës pa e njoftuar më parë familjen.

“Ne ishim në spital. Kur u kthyem, i gjetëm brenda oborrit të shtëpisë. Nuk kam qenë as unë dhe asnjë person nga familja në shtëpi”, shprehet qytetari.

Ai thotë se nuk është kontaktuar apo njoftuar paraprakisht për kontrollin dhe se punonjësit kanë hyrë në pronë në mungesë të familjarëve.

Sipas qytetarit, familja është e rregullt me pagesat e ujit dhe faturat paguhen çdo muaj. Ai mohon që të ketë kryer vjedhje uji apo ndërhyrje të paligjshme në rrjet.

“Faturat e ujit i paguajmë të gjitha. Jemi të rregullt çdo muaj. Na vijnë për kontroll, por nuk e kuptojmë pse hyjnë pa na lajmëruar”, thotë ai.

Qytetari shprehet i shqetësuar edhe për mënyrën se si është kryer kontrolli në ambientet private të pronës. Ai tregon se në oborr mban rrush dhe prodhon raki për përdorim personal dhe thotë se gjatë kontrollit janë prekur edhe këto ambiente.


“Unë aty mbaj rrushin dhe rakinë. Bëj raki vetëm për qejfin tim. Nuk merrem me asgjë tjetër. Kanë futur duart vend e pa vend te rrushi që kam për vete dhe më kanë prishur gjërat aty brenda”, pretendon ai.

Sipas tij, nuk është hera e parë që punonjës të ujësjiellësit paraqiten për kontroll.

“Kanë ardhur disa herë, por nuk kanë gjetur asgjë. Nuk e di nga kush vijnë dhe kush i sjell. Ne nuk vjedhim ujë dhe i kemi faturat të paguara”, shprehet qytetari.

Ai ka dokumentuar këtë situatë edhe me video dhe se në pamje shihen personat brenda pronës.

“Siç e shikoni edhe në video, i kam gjetur brenda oborrit dhe brenda portës. Mesa dimë ne, nuk duhet të hyhet në pronën e dikujt pa qenë në dijeni i zoti i shtëpisë”, thotë ai.



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

Qytetari kërkon që institucionet përgjegjëse të sqarojnë arsyen e kontrollit, praninë e policisë dhe rrethanat në të cilat është kryer hyrja në pronën private, në një kohë kur familjarët nuk ndodheshin në banesë.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.